

EDMOND MALAJ

**TË DHËNA MBI KRISHTERIMIN NË TROJET
ILIRO-SHQIPTARE PARA DHE PAS EDIKTIT TË MILANOS
(VITI 313)
(Me përqendrim tek martirologjia)**

Hyrje

Të hulumtosh mbi historinë e krishterimit në Iliri në katër shekujt e parë të këtij religjioni, nuk është diçka e lehtë pasi, studiuesi që në momentet e para haset me mungesë burimesh dhe dokumentesh, dhe kjo e bën trajtimin shkencor të kësaj periudhe një ndërmarrje të vështirë. Megjithatë, unë po marr iniciativën që të paraqes më poshtë rezultatet e hulumtimit tim në lidhje me këtë temë që është pjesë qoftë e historisë sonë kombëtare në përgjithësi, qoftë të historisë së krishterimit në trojet iliro-shqiptare në veçanti.

Artikullin e mëposhtëm e kam ndarë në katër pjesë. Në pjesën e parë do të bëhet fjalë, shkurt, për përhapjen e krishterimit në Iliri që nga fillimet e tij. Me anë të kësaj, dua të nxjerr në pah edhe një herë, lashtësinë e krishterimit në trojet ilire, me qëllim që të vë në dukje kontaktet e hershme të ilirëve, paraardhësve të shqiptarëve me këtë religjion universal.

Në pjesën e dytë do të jetë fjala për martirizimin e të krishterëve në Iliri, duke u kufizuar në trojet ku jetojnë sot shqiptarët. Ky martirizim zgjati deri në Ediktin e Milanos (13 qershor 313). Aty do të mundohem të sqaroj shkurt shkaqet kryesore që çuan në përndjekjen e të krishterëve në Perandorinë Romake.

Pjesa e tretë e artikullit do t'i kushtohet lirisë së besimit për të krishterët të dalë nga ky edikt dhe duke u mbështetur në literaturë shkencore historike do të reflektoj disa arsye, që e çuan perandorin Konstantin t'u njihte të krishterëve të gjitha të drejtat, që gëzonin religjionet e tjera në Perandorinë Romake, dhe që e bënë atë më vonë ta pranonte këtë besim si të vetin, duke i përgatitur kështu krishterimit rrugën që të bëhej më vonë fe e shtetit.

Pjesa e katërt, si pjesë përmbyllëse, bën fjalë për situatën e kishave të krishtera të Ilirisë pas Ediktit të Milanos, duke përmendur pjesëmarrjen e arqipeshkve dhe ipeshkve ilirë nëpër koncile dhe sinode kryesore, dëshmi e një krishterimi të lartë, i cili pësoi goditjet e para nga dyndjet e sllavëve dhe të popujve të tjerë (avarëve)¹ gjatë shek. VI-X (lëvizjes së popujve), gjë që çoi në zhdukjen e disa ipeshkvive, si Onhezmi, Skampa, Amantia, etj.,² dhe si rrjedhim nuk lejuan që kisha të zhvillohej si duhej në trojet³ shqiptare as para pushtimit osman.⁴ Goditjen kryesore e pësoi nga pushtimi osman, saqë dy të tretat e popullsisë humbën, gjatë këtij pushtimi shumëshekullor, religjionin e krishterë dhe u islamizuan.

Pra, boshti i punimit do të jetë Edikti i Milanos, i cili është edhe pika e kthesës për historinë e krishterimit në Iliri nga një religjion i persekutuar nga vetë shteti romak, në një religjion shtetëror romak. I gjithë artikulli si kornizë kohore do të ketë antikitetin, ndoshta duke hyrë fare pak në Mesjetën e Hershme, duke kaluar nëpër katër faza të historisë së krishterimit në Iliri: Ardhja e Krishterimit, Martirizimi, Liria fetare nga ediktet e tolerancës 311 dhe 313, dhe periudha pas Ediktit të Milanos (313) që dëshmon një zhvillim të këtij religjioni në trojet e Ilirisë, që pasqyrohet në pjesëmarrjen e arqipeshkëvinjve dhe ipeshkëvinjve ilirë nëpër koncile dhe sinode të rëndësishme të historisë së krishterimit.

Përhapja e Krishterimit në Iliri që në zanafillat e tij në trojet iliro-shqiptare

Iliria në kohën e përhapjes së Krishterimit ishte pjesë e Perandorisë Romake. Si qendra më të vjetra të krishtera në Iliri mund të përmend këtu Durrësin⁵, Epidaurumin në Dalmaci (në krahinën e Dubrovnikut të

¹ Marcin Czermiński, *Shqipëria. Përshkrime historike, etnografike, kulturore dhe fetare*, botim i ilustruar, përktheu nga polonishtja Leonard Zissi, Tiranë: Onufri 2014, f. 163.

² *Historia e Popullit Shqiptar*, Vëll. I, Ilirët, Mesjeta, Shqipëria nën Perandorinë Osmane gjatë shek. XVI – vitet 20 të shek. XIX, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: Toena, 2002, f. 203.

³ M. Czermiński, *Shqipëria...*, f. 163.

⁴ *Shënim*: Goditjen kryesore krishterimi në trojet shqiptare e pësoi nga pushtimi osman, saqë dy të tretat e popullsisë humbën, gjatë këtij pushtimi shumëshekullor, religjionin e krishterë dhe u islamizuan.

⁵ Sipas Markus Peters, “*ka të ngjarë që Dioqeza e Durrësit, Dyrrhachium antik, të jetë themeluar që nga koha rreth vitit 58 pas Kr., kështu pra që nga koha e Shën Palit. Për këtë vit disa tradita hagiografike dëshmojnë një ipeshkëv të quajtur Caesarius, një nga “72 dishepujt e Jezu Krishtit”*”. Markus W. E. Peters, *Përballjet e Historisë së*

sotëm), Apoloninë, Vlorën, Nikopojën, Perintin (Manastiri i sotëm) më vonë Shkodrën (Scodra), e Shkupin (Scopia) në provincën e Dardanisë etj, etj. Depërtimi i Krishterimit në Iliri e ka zanafillën që në kohën e Shën Palit, pra, që në dhjetëvjeçarët e parë të ekzistencës së këtij besimi. Dëshmitë e predikimit të tij në trojet ilire, në Epir dhe Maqedoni, i kemi në Besëlidhjen e Re⁶.

Në disa burime shkruhet se apostulli Pal ka qëndruar gjatë periudhës midis viteve 53-58 e. s. në Durrës.⁷ Sipas studiuesit austriak Markus W. Peters, “supozimi që Sh. Pali gjatë udhëtimeve të tij misionare për dhe nga Maqedonia, të ketë kaluar nëpër rrugën Egnatia (Via Egnatia) – një ndër akset kryesore të qarkullimit në atë kohë – në drejtim të Dyrrhachium nuk është pa vend.”⁸ Edhe jezuiti shqiptar Atë Mark Harapi SJ, studiues dhe profesor i Seminarit Papnor në Shkodër në vitet 30-40 të shek. XX, është pro tezës që Shën Pali ka kaluar nëpër trojet shqiptare. Në korrik 1944, Harapi botoi edhe një studim të vogël por interesant me titull “Shën Pali në Shqipni”, ku citon shumë burime të ndryshme antike biblike, shekullare e hagiografike dhe nxjerr si konkluzion që apostulli Pal mund të ketë shkelur me të vërtetë në territoret e sotme të Shqipërisë.⁹ Një studiues tjetër që e mbështet deri në njëfarë mase këtë është edhe jezuiti polak dhe historiani Atë Marcin Czermiński SJ, cili në veprën e tij “Shqipëria” shkruan se, “sipas traditës, Shën Pali ishte apostoliku i parë që solli fjalën e Zotit në Shqipërinë e sotme”¹⁰.

Megjithatë mbi qëndrimin e Palit në Iliri ka edhe qëndrime të kundërta. Gaspër Gjini shkruan se, “askund nuk përmendet se Pali ka ardhur vetë në Ilirik. Prandaj ka shkrimtarë të cilët mendojnë se shprehja

Kishës Katolike në Shqipëri (1919-1996), përktheu nga gjermanishtja Klaudia Darragjati, Tiranë: Qendra Botuese Shoqata Jezuite, 2010, f. 15.

⁶ Përkatësisht tek: Rom. XV, 19; Titi III, 12; Vep. Ap. XVII, 1-5; 2 Kor VII, 5; Selan I, 2. (Bibla Besëlidhja e Re).

⁷ Zef Mirdita, “Gjashtë shekujt e parë të Krishtenizmit në trevat iliro-shqiptare”, në: Simpoziumin ndërkombëtar *Krishtërimi ndër shqiptarë*, Tiranë, 16-19 nëntor 1999, Konferenca Ipehkvnore e Shqipërisë, Editorë: Dom Nikë Ukgjini, Willy Kamsi, Romeo Gurakuqi, Shkodër: Phoenix 2000, f. 39.

⁸ M. Peters, *Përbaljet e Historisë së Kishës Katolike në Shqipëri ...*, f. 15.

⁹ Mark Harapi, “Shën Pali në Shqipni (Nga vepra në shtyp: Le’ të këndojmë!)”, në: *Lajmtari i Zemres se Krishtit 54* (1944), f. 112, cituas sipas: Markus W. E. Peters, *Der älteste Verlag Albaniens und sein Beitrag zu Nationalbewegung Bildung und Kultur. Die “Buchdruckerei der Unbefleckten Empfängnis zu Shkodra (1870-1945)*, Hamburg: Dr. Kovač 2007, f. 389.

¹⁰ M. Czermiński, *Shqipëria ...*, f. 162.

“*deri në Ilirik*” e përjashton mundësinë e vizitës së tij dhe të predikimit në këtë vend të njohur. Sipas tyre Pali arriti vetëm në kufijtë e tij, por nuk i kaloi.”¹¹

Ndër apostuj, nuk është vetëm Pali, i cili mund të ketë ungjillëzuar në Iliri. Edhe për apostullin Matia, ka të dhëna që ka predikuar në trojet ilire. Një tezë në lidhje me këtë e paraqitur nga Jakobo Coleti (Jacobo Coleti) dhe Daniele Farlati thotë se në Iliri tek dardanët, në Maqedoni tek maqedonët, tribalët dhe bastarnët ka predikuar ungjillin (ose po ta përkthejmë fjalë për fjalë – i ka mbushur me religjionin e krishterë) edhe vetë apostulli Matia.¹² Nuk duhet të ngatërrojmë këtu apostullin Matia me evangjelistin Mateu siç ngatërrohet emri Matias me Mateus në disa studime.¹³

Ndërsa, përsa i përket Andreas, që sipas Eusebit, ka predikuar edhe në Ballkan, për këtë nuk mund të gjenden të dhëna.¹⁴ Sipas Farlatit dhe Czermiński, edhe Shën Titi që ishte shoqërues i Palit, ka predikuar në trojet ilire,¹⁵ dhe duhet të ketë hyrë në këtë tokë aty rreth viteve 50 të shek. I, dhe në vitin 45 ose në vitin 62 duhet të jetë caktuar edhe si

¹¹ Gaspër Gjini, *Ipeshkvia Shkup-Prizren nëpër shekuj*, përktheu Mirie Rushani, Prizren: Drita, 2011, f. 23.

¹² “[...] *Mathiæ gentes Mecedonum, Dardanorum, Triballorum, Bastarnorum Evangelum imbuendas traditas fuisse*”. *Illyrici Sacri*, Tomus primus: Ecclesia Salonitana: ab ejus exordio usque ad saeculum quartum aerae Christianae. Auctore Daniele Farlato presbytero Societatis Jesu. Venetiis, MDCCLI. Aput Sebastianum Coleti. Superiorem permissu ac privilegio, f. 254. (Në vijim cituar si. D. Farlati, *Illyricum Sacrum I*, f.)

“*Diximus in I. Tomo Dardanos a D. Apostolo Matthia fuisse Christiana religione imbutos, quam alii dende Apostolici viri excoluerunt*” *Illyrici Sacri. Tomus Octavus. Ecclesia Scopiensis, Sardicensis, Marrcianopolitana, Achridensis et ternobensis, cum earum suffraganeis*. Auctore Jacobo Coletto, olim Presbytero Societatis Jesu. Venetiis, MDCCCXIX. Aput Sebastianum Coleti. Superiorem permissu ac privilegio, f. 1. (Në vijim cituar si. J. Coleti, *Illyricum Sacrum VIII*, f.)

¹³ Një ngatërresë të tillë emrash e bën edhe historiani i njohur i kishës Dr. Gaspër Gjini në veprën “*Ipeshkvia Shkup-Prizren nëpër shekuj*”. Ai në lidhje me këtë shkruan se: “*Në veprën «Illyricum Sacrum» Farlati thekson se apostulli Mateu, është zgjedhur në vend të Judës që t’i fuste në Krishtërizëm maqedonët, dardanët, tribalët dhe bastarnët. Por kjo e dhënë duket pothuajse e pabesueshme kur dijmë se i njëjti, Mateu ka predikuar në Mesopotaminë e Largët*”. G. Gjini, *Ipeshkvia Shkup-Prizren nëpër shekuj* ..., f. 25.

¹⁴ *Po aty*.

¹⁵ M. Czermiński, *Shqipëria* ..., f. 162.

peshkop i Dalmacisë¹⁶. Një figurë tjetër e rëndësishme e krishterimit të hershëm, më saktë e zanafillave të këtij religjioni, që ka dhënë kontributin e tij në Iliri pikërisht në rojet e sotme shqiptare që edhe Shën Çezari, i cili u bë edhe ipeshkvi i parë i Durrësit në vitin 58 të shek I.¹⁷ Shën Çezari i përket brezit të parë të besimtarëve të krishterë dhe ishte njëri ndër 70 dishepujt e Jezus Krishtit,¹⁸ dhe përmendet edhe në Besëlidhjen e Re, në Letrën e Palit dërguar Filipianëve.¹⁹

Përveç misionarëve, disa nga të cilët, siç e pamë edhe më sipër, kishin qenë drejtpërdrejtë dishepujt e Jezus Krishtit, për përhapjen e krishterimit ndikoi edhe një fenomen tjetër, ardhja e të krishterëve romanë në trojet ilire, sidomos gjatë kohës së përndjekjeve nga ana e perandorëve. Bashkë me kolonë romanë, vinin e vendoseshin në këto troje edhe të dëbuarit e krishterë,²⁰ të cilët kontribonin qoftë në përhapjen e krishterimit qoftë në forcimin e tij. Më vonë, ngaqë shkalla e civilizimit në vend ishte e lartë, u bë e mundur që ky religjion të pranohej lehtë.²¹

Megjithatë që në fillimet e tij, deri në fillim të shek. IV, krishterimi në Perandorinë Romake, që një religjion i përndjekur dhe si rrjedhojë edhe në Iliri pasi krahinat ilire ishin pjesë e Perandorisë Romake. Historia e krishterimit në Iliri është e mbushur me martirë, disa prej të cilëve po i përmend në pjesën e dytë të këtij artikulli.

Përndjekja e të krishterëve në Iliri, deri para Ediktit të Milanos

Martirët e krishterë në iliri janë të shumtë. Historiani jezuit Atë Marcin Czermiński SJ flet edhe për martirizime në masë brenda koloseut të stilit romak (është fjala këtu për amfiteatrin) në Durrës që bëheshin pre e kafshëve të egra.²² Albanologu i famshëm italian At Zef Valentini SJ (Giuseppe Valentini), në një studim të tijin me titull: “*Vargu i*

¹⁶ D. Farlati, *Illyricum Sacrum I*, f. 375. Sipas Farlatit data e emërimit të Titit ipeshkëv i Dalmacisë është e diskutueshme.

¹⁷ “*Fuit unus de septuaginta Christi discipulis & primus Dyrrachii Episcopus.*” D. Farlati, *Illyricum Sacrum VII*, f. 341.

¹⁸ M. Czermiński, *Shqipëria ...*, f. 162.

¹⁹ *Filipianëve*, 4: 22 (Bibla, Besëlidhja e Re).

²⁰ M. Czermiński, *Shqipëria ...*, f. 162.

²¹ *Po aty.*

²² *Po aty*, f. 163.

*lumnueshëm i fatosave iliro-shqiptarë*²³ jep një listë të përbërë prej dhjetëra e dhjetëra emrash dëshmorësh dhe të shenjtëruarish të krishterë, të shoqëruar me të dhëna për shumë prej tyre, porse këto figura i përkasin të gjithë trojeve ilire në përgjithësi. Kështu unë do të kufizohem vetëm në ato troje ku jeton sot populli shqiptar.

Si martirin e parë të krishterë në trojet ilire mund të përmendim këtu Danaksin nga Vlora, i cili ka jetuar dhe ka vdekur në shekullin e parë. Ai ishte prift i krishterë dhe ra martir në përpjekje për të shpëtuar enët e shenjta sakrale nga plaçkitësit.²⁴ Sipas një legjende tjetër ai nuk pranoi që t'i bënte flijim perëndisë pagane latine Bakus (gr. Διόνυσος), dhe për këtë iu pre koka.²⁵ Z. Valentini i bashkon të dyja variantet në një të vetme. Ai shkruan që Danaksi, “i ngrehun rshanë prej të pafeve para lterit të Dionizit, hyjit të venës, për ti bamun fli, s’ deshi të dëftonte se ku i mbante enët e shenjta të Kishës, as të kapte kupën e venës së përlyeme të Dionyzit. Iu turrën ushtarët pagaj me shpata e dëshmori ra vdekun mbushë me varre e me krye të këputun.”²⁶ Nuk dimë as datën e saktë të lindjes dhe as datën e plotë të martirizimit e cila nga Farlati jepet më 16 janar, pa vit, por jemi të mendimit se i përkiste shekullit të parë të erës së krishterë.

²³ At Giuseppe (Zef) Valentini, “Vargu i lumnueshëm i fatosave iliro-shqiptarë”, në: At Giuseppe (Zef) Valentini, *Studime dhe tekste për lindjen e krishterë*, Tiranë: Plejad 2010, f. 467-483. Lista e lartpërmendur arrin numrin 588, por jo të gjitha numrat janë të shoqëruara me emra konkretë.

²⁴ “Danax”, në: *Ökumenisches Heiligenlexikon*. URL: <http://www.heiligenlexikon.de/BiographienD/Danax.htm> (15. 8. 2013).

²⁵ *Vollständiges Heiligen-Lexikon oder Lebensgeschichten aller Heiligen, Seligen etc. etc. aller Orte und aller Jahrhunderte, deren Andenken in der katholischen Kirche gefeiert oder sonst geehrt wird, unter Bezugnahme auf das damit in Verbindung stehende Kritische, Alterthümliche, Liturgische und Symbolische, in alphabetischer Ordnung*. Herausgegeben von J. E. Stadler, F. J. Heim und J. N. Ginal. Band 1. (A–D), Augsburg: B. Schmid'sche Verlagsbuchhandlung, 1858, f. 722.

²⁶ G. Valentini, *Studime dhe tekste*, f. 473-474. Krahaso edhe: “*Hic enim, inquit Menæ, ex Illorico oriundus, loco qui Aulon dicitur clericus fuit sanctæ Dei, quæ ibidem erat, Ecclesiæ, Cum sacra vasa acceppisset, ut illa ab inkursione infidelium servaret, quam loco ab illis deprebensas jussus est Baccho sacrificare. Sed cum id ut ageret induci non posset, gladiis eorum confessus occubuit*” *Illyrici Sacri. Tomus Septimus, Ecclesia Diocletiana, Antibarensis, Dyrrhachiensis et Sirmiensis, cum eorum suffraganeis*. Auctore Daniele Farlato, Presbytero Societatis Jesu, et Jacobo Coletio olim ejusdem Societatis alumno. Venetiis, MDCCCXVII. Aput Sebastianum Coleti. Superiorem permissu ac privilegio. (Botim i dytë. Prishtinë: Arbi 2004.), f. 397. (Në vijim cituar si: D. Farlati, *Illyrici Sacri VII*, f.)

Fillimet e para të dokumentuara të persekutimit të krishterëve i kemi në vitin 64 të shek. I, nën Perandorin Neron, i cili i akuzoi të krishterët për shkak të zjarrvënieve të presupozuara, edhe si kriminelë, dhe u bë kështu persekutori i parë sistematik i të krishterëve.²⁷ Gjatë sundimit të këtij perandori nuk kemi të dhëna rreth persekutimeve që mund të kenë ndodhur në trojet ilire. Persekutime të tjera të një natyre lokale përjetuan të krishterët edhe në kohën e Domitianit (81-96),²⁸ dhe këto persekutime lidhen veçanërisht me ata persona në Azinë e Vogël, sidomos në Efesus, të cilët nuk pranonin të adhuronin kultin perandorak, që në atë kohë kishte marrë një rëndësi të veçantë.²⁹ Këto persekutime nuk kishin akoma as mbështetje ligjore dhe as dekrete kundër të krishterëve. Gjatë kësaj kohe nuk kemi të dhëna në lidhje me persekutime ndaj të krishterëve në Iliri.

Ndonjë e dhënë gjendet më vonë në kohën e Perandorit Trajan (98-117). Në vitin 112-113 kemi të ashtuquajturën letër të Plinit drejtuar Perandorit Trajan, ku pyeste se çfarë duhet të bënim me të krishterët me fe tjetër që nuk pranonin kultin perandorak dhe perënditë romake, pasi ai nuk i njohte dhe nuk dinte si t'i dënonte duke pasur parasysh moshën, etj.³⁰ Për këtë Perandori Trajan lëshoi një dekret, ku thuhej se të krishterët nuk duhej të ndiqeshin, por nëse kishte thyerje lojaliteti ndaj *kultit të hyjnive romane* atëherë kjo ishte e dënueshme, por nëse ata e mohonin se ishin të krishterë dhe fillonin t'u luteshin perëndive romake, do të faleshin.³¹

²⁷ Karl Christ, *Geschichte der römischen Kaiserzeit: Von Augustus bis zu Konstantin*. 6. Auflage mit aktualisierter Bibliographie. München: Beck 2009, f. 240.

²⁸ *Po aty*, f. 283.

²⁹ *Po aty*.

³⁰ "*Sollemne est mihi, domine, omnia de quibus dubito ad te referre. quis enim potest melius uel cunctationem meam regere uel ignorantiam instruere? cognitionibus de Christianis interfui numquam: ideo nescio quid et quatenus aut puniri soleat aut quaeri. nec mediocriter haesitavi, sitne aliquod discrimen aetatum, an quamlibet teneri nihil a robustioribus differant, detur paenitentiae uenia, an ei qui omnino Christianus fuit desisse non prosit, nomen ipsum, si flagitiis careat, an flagitia cohaerentia nomini puniantur*". Brief X 96: C. Plinius an Kaiser Trajan. URL: <http://www.uni-siegen.de/phil/antiketexte/ausser/8.html?lang=de> (15. 5. 2013)

³¹ "*ita tamen ut qui negauerit se Christianum esse idque re ipsa manifestum fecerit, id est supplicando dis nostris, quamuis suspectus in praeteritum, ueniam ex paenitentia impetret.*"

Brief X 97: Traianus Plinio. URL: <http://www.uni-siegen.de/phil/antiketexte/ausser/8.html?lang=de> (15. 5. 2013)

Pra, ky dekret në mënyrë faktike e bënte të qëniti të krishterë të dënueshëm. Pikërisht në kohën e Trajanit dhe për shkak të këtij dekreti bie martir Shën Asti, ipeshkvi i Durrësit.³² Ai arrestohet nga paria e qytetit e përbërë nga Numerius, Nearku, Aglaidhi dhe Ariani. Para se të ekzekutohet ai sheh një ëndërr. Aty ai e sheh veten mbi një gur, të lyer me katran dhe me vaj (*vidid seipsum supra petram stare unctum pico et oleo*) dhe kështu me t'u zgjuar, meqë e parandien se do të ekzekutohej, u çon fjalë klerikëve të tij, që të iknin ku të mundnin e të shpëtonin, pasi atij i duhet që të vdiste për Krishtin.³³

Shën Asti nuk pranoi t'i bëjë flijim idhujve romakë, sidomos Dionizit³⁴, dhe kështu e dorëzoi tek qeveritari romak Agrikola, i cili në fillim u përpoq t'i ndryshonte mendjen me qëllim që ai të mohonte Krishtin e më pas e kërcënoi, gjë që nuk solli asnjë rezultat. Qeveritari Agrikola i tërbuar nga qëndrimi i Astit e la atë ta torturonin, duke e rrahur me kamxhikë prej lëkure kau të pajisur me sfera plumbi, e më pas, e lye me mjaltë dhe e kryqëzuan mbi dru, pranë mureve të qytetit, ku i pickuar nga gërëzat dhe insektet e tjera dha shpirt si i krishterë më 6 apo 7 korrik.³⁵ Daniele Farlati, i cili na jep të dhëna më tepër se autorë të tjerë në lidhje me martirizimin e Shën Astit, jep si burim në lidhje me atë, veprën "*Menologium Basilianum apud Hagiographos Antverpienses Tomo 2*"³⁶

³² M. Peters, "Die ekklesiale Geographie", në: *Krishtërimi ndër shqiptarë*, f. 114.

³³ D. Farlati, *Illyricum Sacrum VII*, f. 342. Shih më poshtë historinë e plotë të martirizimit sipas Farlatit.

³⁴ Robert Elsie, "The Christian Saints of Albania", në: *Balkanistica*, University of Mississippi, 13, 2000, f. 36.

³⁵ Po aty. Shih edhe: "*Certamen sacrosanti Martyris Asteii episcopi Dyrrachii. Asteijus sanctus Martyr vixit sub Trajano Imperatore. Ab idilolatriis captus Agricolao Præsidi traditus ist. Cumque jussus esset Christum negare, et idolis sacrificare, neque eo adduci posset, in carcerem missus est. Porro prosquam comprehendaretur, tale habuit somnium. Vidid seipsum supra petram stare unctum pico et oleo; expergefactus dixit Clericis suis; Fratres, oportet me pati propter Christum.. Cæterum unusquiesque vestrum discedat, ubi salvus esse possit. Hæc locutus combrebensus est, ut dictum; et stans coram Agricolao, Christumque confessus in carcere conclusus fuit. Unde dimissus pumbatis cæsus, de miele unctus suspensus fuit in lingo tempore estivo, ut vespis et muscis depastus e vita excederet. Hoc facto, gratanter cruciatum preferens animam animam Christi tradidit.*" D. Farlati, *Illyricum Sacrum VII*, f. 342.

³⁶ Po aty.

Lipsanin e Shën Astit e morën të krishterët dhe e varrosën duke ngritur edhe një kishë mbi të.³⁷ Sipas legjendës, në ditën e martirizimit të Shën Astit, kishin ardhur nga Italia me një anije edhe shtatë bujarë romakë të krishterë, të cilët qenë larguar nga vendi i tyre për t'i shpëtuar persekutimit që kishte filluar Perandori Trajan.³⁸ Por kur panë qëndrimin burrëror të Shën Astit, deklaruan haptazi që ishin të krishterë. Atëherë Agrikola urdhëroi që të mbyteshin në det. Emrat e tyre qenë Peregrini, Lukjani, Pompeu, Heziku, Papia, Staurini dhe Germani. Të shtatë i mbytën në detin Adriatik.³⁹ Në kohën e sundimit të Trajanit u martirizua edhe Shën Ignaci (midis viteve 98-117, shek. I-II) peshkop i Antiokisë. Ai, sipas një tradite, nga Siria qe sjellë në Durrës, ku e lanë për disa kohë, dhe prej portit të Durrësit qe transportuar për në Romë, ku u torturua dhe u martirizua.⁴⁰ Gjatë sundimit të Perandorit Hadrian (117-138 e. s.) dhe në kohën e Mark Aurelit (161-180) gjithashtu kemi persekutime të krishterëve.⁴¹

Gjatë sundimit të Perandorit Hadrian ndodh edhe martirizimi i Shën Lefterit (Eleutherius). Shën Lefteri ishte me prejardhje nga Roma dhe u bë peshkop i Mesinës dhe i Ilirisë kur ende nuk kishte mbushur njëzet vjeç.⁴² Mesa duket ai ka jetuar në Vlorë, dhe rreth jetës së tij nuk dimë më tepër, përveç faktit, që u thirr në Romë rreth viteve 117-120 dhe atje u martirizua bashkë me të ëmën, Shën Anthin (Anthia) dhe njëmbëdhjetë shokë, gjatë një fushate përndjekjeje anti-të krishterë.⁴³ Dita e festës së tij është 18 prilli.

Ndoshta gjatë këtyre kohëve ndodhi martirizimi i Shën Florit dhe Shën Laurit, megjithatë datën e saktë të martirizimit të tyre nuk e dimë akoma. Këta dy shenjtorë ishin muratorë dhe gurëgdhendës. Sipas një publikimi të Kishës Ortodokse ata ishin vëllezër qoftë të gjakut, qoftë të

³⁷ Shën Asti, ipeshkëv i Durrësit e martir. URL:

<http://www.famulliabinqes.com/kulture/Shen%20Asti%20ipeshkev%20i%20Durresit%20e%20martir.pdf> (10. 8. 2013)

³⁸ G. Valentini, *Studime dhe tekste...*, f. 470.

³⁹ Andrea Llukani, *Historia e Krishtërimin në Shqipëri*. URL: <http://allukani.narod.ru/indeks6.htm> (10. 8. 2013).

⁴⁰ M. Czermiński, *Shqipëria...*, f. 163.

⁴¹ Michael Grant, *Konstantini i Madh nga Iliria*, përktheu nga anglishtja Klodian Boriçi, Tiranë: Bacchus, 2004, f. 151.

⁴² R. Elsie, "The Christian Saints of Albania ...", f. 36.

⁴³ Po aty.

besimit.⁴⁴ Bashkë me ta u torturuan punëtorët e tyre Prokuli (Proculus) dhe Maksimini (Maximus) ngaqë kishin punuar në ndërtimin e një tempulli pagan, që pastaj e kishin kthyer në kishë të krishterë. Sipas një burimi tjetër, Prokuli dhe Maksimi, të cilët edhe vetë ishin të krishterë, nuk qenë punëtorët, por mësuesit e tyre, të cilët u mësuan dy vëllezërve besimin e krishterë.⁴⁵ Flori dhe Lauri u martirizuan, duke i zhytur në pus, pasi i kishin torturuar.⁴⁶ Në lidhje me këta dy martirë, në këtë artikull do të ndalem pak më gjatë, pasi ata kanë lidhje të drejtpërdrejtë me Kosovën. Disa autorë i lidhin Florin dhe Laurin me ngulimet e lashta të Ulpianës, në jug të Prishtinës.⁴⁷

Të ndjekim më tej legjendën.⁴⁸ Sipas saj, dy vëllezërit muratorë u dërguan në Iliri (pra me shumë mundësi këtu në Kosovë) nga prefekti romak i Ilirisë Likaion për të ndërtuar tempullin pagan të lartpërmendur dhe të gjitha paratë që fitonin me mund në punë ua shpërndanin të varfërve, ndërsa për vete ata agjëronin dhe luteshin pa pushim. Një ditë pranë ndërtimit, po kalonte i shkujdesur i biri i priftit pagan Memartin. Nga ndërtesa shkëputet një copë gur dhe e godet atë në sy duke e dëmtuar rëndë. Dy shenjtorët e qetësojnë të atin e shqetësuar, duke i premtuar atij që i biri do të shërohet. Ata e sollën në vete të birin e priftit pagan, i cili për shkak të goditjes kishte mbetur pa ndjenja dhe i predikuan për Jezu Krishtin. I riu u bind dhe e pranoi Krishtin si Zotin e vërtetë pasi shenjtorët u lutën për të. Syri i djaloshit u shërua menjëherë dhe kur prifti pagan, i ati i djalit pa këtë mrekulli, u bë edhe ai i krishterë.

⁴⁴ Martyr Florus of Illyria. URL: <http://oca.org/saints/lives/2013/08/18/102324-martyr-florus-of-illyria> (13. 9. 2013).

⁴⁵ G. Valentini, *Studime dhe tekste*, f. 476.

⁴⁶ “*In Illyrico sanctorum martyrum Flori & Lauri artis lapidicinæ, qui, cunsumtis martyrio eorum magistris Proculo & Maximo, sub Licione Præsidi post multa tormenta in profundum puteum sunt demersi.*” Martyrologium Romanum Gregorii XIII. Jussu Editum Urbani VIII & Clementis X. Auctoritate recognitum. Editio Novissima a sanctiss. Dom. Nostro Benedicto XIV. Pontefice maximo. Aucta, et castigata: In Qua Nonnulla Sacntorum Nomina in præteritis Editionibus ommissa supplentur; alia item Sanctorum & Beatorum Nomina ex integro adduntur. Venetiis: Typis Francisci ex Nicolao Pezzana MDCCLXXXIV, f. 158. (Cituar si: Martyrologium Romanum, f.)

⁴⁷ R. Elsie, “The Christian Saints of Albania ...”, f. 36.

⁴⁸ Legjenda që po jepet në vazhdim është marrë nga siti zyrtar i Kishës Ortodokse në Amerikë: Martyr Florus of Illyria. URL: <http://oca.org/saints/lives/2013/08/18/102324-martyr-florus-of-illyria> (13. 9. 2013)

Dy shenjtorët, pasi përfunduan ndërtimin e tempullit, i mblodhën rreth vetes të krishterët e tjerë dhe thyen të gjithë idhujt që ndodheshin aty brenda. Në pjesën lindore të tempullin vendosën Kryqin. Aty ata kaluan gjithë natën duke u lutur, të ndriçuar nga një dritë qiellore. Me të dëgjuar këtë ndodhi guvernatori i distriktit i dënoi me vdekje (me djegie për së gjalli) Mamertinin që më parë ishte prift pagan, të birin e tij dhe të 300 të krishterët e tjerë. Martirët Flor dhe Laur u kapën dhe u dërguan edhe një herë tek prefekti Likaion, i cili i hodhi ata në një pus bosh dhe i mbuloi me dhe duke mbushur edhe një herë pusin. Pas shumë vitesh, të krishterët e gjetën vendin, i zhvarrosën shenjtorët dhe asistuan në një mrekulli të dytë, trupat ishin të paprishur. Ato u dërguan në Konstandinopojë.

Sipas një legjende tjetër, shenjtorët iu shfaqën mbi një mijë vjet më vonë, diku në vitin 1200 një pelegrini me emrin Anton nga Novgorodi, dhe po në Novgorod në vitin 1350 kokat e martirëve iu shfaqën edhe një personi me emrin Stefan i Novgorodit.⁴⁹ Kjo sipas traditës ndodhi në manastirin e Pantokratorit.

Interesant në këtë legjendë është, se aty flitet për një komunitet të krishterë prej 300 vetësh diku në trojet ilire. Kjo tregon në mënyrë indirekte përmasat e përhapjes së krishterimit në Iliri që në shekullin e dytë, me gjithë persekutimet sistematike. Këta dy shenjtorë, Flori dhe Lauri së bashku me Prokulin (Proculus) dhe Maksimin (Maximus) ditën e festës së tyre e kanë më 18 gusht.⁵⁰

Si përndjekës të rreptë të të krishterëve mund të përmendim këtu Maksiminin I Traksin (235-238), Trajan Decin (249-251) si dhe Dioklecianin.⁵¹

Në lidhje me përndjekjet ndaj të krishterëve në Iliri gjatë kohës së perandorit Decius (249-251) mund të përmendim këtu martirizimin e Izaurusit në Apoloni dhe të Shën Terinit (Therinus) nga Butrinti i lashtë në jug të Shqipërisë.⁵² Shën Terini u ther bashkë me një numër martirësh të tjerë. Dita e festës së tij është 23 prilli, datë e njëjtë me atë të Shën Gjergjit.⁵³ Përsa i përket martirizimit në kohën e Dioklecianit (Gaius

⁴⁹ Po aty.

⁵⁰ "Florus, Laurus, Proculus, & Maximus. 18. Aug." Martyrologium Romanum. Index, f. 14.

⁵¹ M. Grant, *Konstandini i Madh*, f. 151.

⁵² M. Peters, "Die ekklesiale Geographie ...", f. 103, 114.

⁵³ R. Elsie, "The Christian Saints of Albania ...", f. 36.

Aurelius Valerius Diocletianus* Spalato (Split) rreth 243 – † rreth 313) mund të përmendim atë të *Shën e Erazmit të Antiokisë*, i cili në fakt u martirizua në Formi të Italisë, por veprimtaria e tij misionare shtrihet edhe në Iliri, përkatësisht në Ohër dhe në Durrës, nga ku niset pastaj për në Gadishullin Apenin.⁵⁴

Ai vdes i persekutuar nga Diokleciani në vitin 303 si ipeshkëv i Formit. Por sipas një legjende tjetër, ai u martirizua në Iliri (diku në Kroaci), duke e çarë në bark dhe duke i nxjerrë të brendshmet përjashta.⁵⁵ Në kohën e Dioklecianit kemi edhe martirizimin e *Agatonit* me tri motrat e veta të krishtera *Agape*, *Hione* dhe *Irene* nga Maqedonia të cilat për shkak të besimit të tyre u martirizuan në Selanik, më 1 prill të vitit 304, ngaqë nuk pranuan, as t'u bënin fli perëndive pagane romake dhe as të hanin nga mishi i kafshëve të flijuara për nder të tyre.⁵⁶ Si rrjedhim u dogjën të gjalla. Këto tri motra vinin në fakt nga një shtëpi (familje) pagane, por që në rini ishin kthyer në besimin e krishterë, dhe për shkak të këtij besimi u arratisën nëpër malet e Maqedonisë në vitin 303, por u kapën nga romakët, iu dorëzuan Dulçecit, administratorit të Maqedonisë, dhe u dënuan me vdekje.

Zef Valentini, i cili po ashtu jep të dhëna në lidhje me martirizimin e tyre, jep një datë tjetër, duke e spostuar ekzekutimin e tyre në mars të vitit 204.⁵⁷ Megjithatë Valentini nuk e përmend emrin e perandorit romak të asaj kohe. Po gjatë kohës së Dulçecit, sipas Valentinit u martirizuan edhe tri gra të tjera, të cilat ishin Kasja, Filipja dhe Eutikja, ndaj të cilave Dulçeci përdori çdo mjet për t'u ndërruar mendje, por edhe këto gra nuk e ndërruan besimin dhe kështu porsi Irene me të motrat u hodhën në zjarr duke kënduar psalme.⁵⁸

Më tej, edhe pse nuk lidhet direkt me trojet ilire, mund të përmend këtu edhe Shën Luçinë e Sirakuzës (283-310), e cila u martirizua pak kohë para se të ndodhte legalizimi i Krishterimit nga Perandori Konstandin i Madh nëpërmjet Ediktit të Milanos, dhe për shkak të

⁵⁴ G. Gjini, *Ipeshkvia Shkup-Prizren nëpër shekuj ...*, f. 24.

⁵⁵ Ausgewählte Gedenktage der Römisch Katholischen Kirche Teil 2 April bis Juni. URL: <http://www.familie-wimmer.com/projekte/p03/p03gt/gt-2.html> (20. 8. 2013)

⁵⁶ Friedrich Wilhelm Bautz, "Agape, Chione und Irene", në: *Biographisch-Bibliographisches Kirchenlexikon*. Band 1. 2., unveränderte Auflage Hamm: Bautz 1990, Sp. 52.

⁵⁷ G. Valentini, *Studime dhe tekste ...*, f. 475.

⁵⁸ *Po aty*.

qëndrimit të saj plot kurajo, e bënë më vonë pajtore të qyteteve portale Sirakuzë, Venedik dhe Durrës.⁵⁹

Së fundi, e shoh të rëndësishme të përmend këtu edhe të famshmin Donat, ipeshkëv të Eururesë (Paramithi apo Ajdonat në krahinën e Çamërisë, i cili jetoi dhe veproi deri në gjysmën e parë të shek. IV, edhe pse ky nuk futet në listën e martirëve.⁶⁰ Donati mbahet si ndërtuesi i dy kishave, njërenë në Saronë dhe tjetrën në Lustonë. Sipas, G. Valentinit, “*në kujtim të tij në qytezë të Euresë u ngrit mungadja* e Shën Donatit, në lulzim deri qi Epiri ra nën sundimin turk, e pa u kujtue zaptuesit, vendit i qe ngjitur emni nga ata vetë Ajdonat Kalas, Kalaja e Shën Donatit*”⁶¹.

Në lidhje me provincën e Prevalit, përsa i përket martirizimit të krishterëve, nuk kemi të dhëna për ndonjë kult të krishterë martirësh aty (as martirësh vendas por as martirësh të huaj).⁶² Kulti i Shën Bakut dhe i Shën Shirgjit ka hyrë më vonë (gjatë Mesjetës) në këtë zonë mesa duket nëpërmjet Raguzës. Duhet të theksoj këtu se që të studiosh historinë e krishterimit në dy shekujt e parë të tij në trojet ilire është e vështirë, pasi ka mungesë të madhe burimesh dhe si rrjedhojë, është pothuaj e pamundur të përcillet zhvillimi i Krishterimit dhe i kishës në këto treva.⁶³

Tani lind pyetja, pse u persekutuan të krishterët në Perandorinë Romake? Këtu kanë të bëjnë një sërë faktorësh që po u jap një sqarim si më poshtë. Perandoria Romake ishte një shtet që e lejonte pluralizmin fetar. Krahas religjioneve të ndryshme ekzistonte edhe religjioni i *kultit të perandorit* që ishte mbartur që nga Orienti dhe ishte futur në perandori qysh me perandorin Augustus.⁶⁴ Pra në Perandorinë Romake mund t’i

⁵⁹ Markus W. E Peters, *Der älteste Verlag Albaniens und sien Beitrag zur Nationalbewegung, Bildung und Kultur. Die “Buchdruckerei der Unbefleckten Empfängnis” zu Shkodra (1870-1945)*. Hamburg: Dr. Kovaç 2007, f. 386. (=Schriftenreihe *Studien zur Kirchengeschichte* Band 6). Për këtë shenjtore një Vita prej 37 faqesh edhe shkrintari rilindas, Ati Françeskan Gjergj Gjeçovi OFM me titull “Pajtorja e Durzit A se Sc’ Lucia V. E M. n’ kreme, gasetmdhetcinnore t’veten Jetsckroi e sckurt e cit për kuides t’ P. Sctiefnit K. Ghecov OFM”. Po aty.

⁶⁰ Të dhënat për Donatin nga: G. Valentini, *Studime dhe tekste ...*, f. 473.

* *Mungade* = manastir.

⁶¹ *Po aty*.

⁶² Gëzim Hoxha, “Procesi i Kristianizimit në Provincën e Prevalit”, në: *Krishtërimi ndër shqiptarë*, f. 74.

⁶³ Z. Mirdita, “Gjashtë shekujt e parë të Krishtenizmit ...”, f. 43-44.

⁶⁴ Jörg Dittmer “Einleitung zur Gattung und zum historischem Umfeld der Märtyrerakten”. URL:

faleshe pa problem perëndive që besojë, por duhej që të respektoje dhe të pranoje edhe kultin perandorak. Nëse e bëje këtë i thoje “*po!*” shtetit romak dhe ligjeve të tij, por nëse mundoheshe të distancoheshe nga kultin perandorak bëje një krim politik (*crimen laesae maiestatis imperatorum*) dhe kjo ishte e dënueshme deri me vdekje.⁶⁵

Tani të krishterët e kishin të urdhëruar që duhet të pranonin dhe të respektonin shtetin dhe ligjin, po ashtu ata pranonin edhe një autoritet, rend apo sundimtar (që mund të ishte pagan) (Rom 13, 1-7), sepse pushteti vjen prej Hyjit dhe është shërbëtor i tij,⁶⁶ dhe ata ishin më se dakord që t’i jepnin *Cezarit atë që i takonte Cezarit* (Mt 22,21)⁶⁷, pra tatime, taksa apo detyrime të tjera që duhet të paguanin. Por nuk mund t’i jepnin Cezarit atë që i takonte Zotit, pra adhurimin ndaj perandorit, sikur të ishte Zot, pasi kjo ishte një idhujtari e pastër. Feja e Krishterë ishte pra një fe monoteiste dhe Zoti i të krishterëve nuk pranonte Zot tjetër.

I krishteri nuk mund t’i besonte idhujve dhe detyrimisht as kultit të perandorit dhe kjo gjë e bënte atë automatikisht si refuzues të shtetit dhe të rendit. Sikur të krishterët në Perandorinë Romake, krahas praktikimit të religjionit të tyre do të kishin pranuar edhe kultin perandorak, atëherë ata nuk do të kishin përjetuar persekutimet e martirizimit që u ndodhën.⁶⁸ Përveç kësaj në perandori ishte hapur fjala se nëpër

<http://www.chairete.de/Beitrag/Passio%20Perpetuae/Einleitung%20Maertyrerakten.pdf> (10. 9. 2013)

⁶⁵ Po aty.

⁶⁶ “Rom 13, 1-7: ¹Çdo njeri le t’i nënshtrohet autoritetit që ka mbi vete. Sepse, nuk ka pushtet që nuk vjen prej Hyjit: ato që janë i ka vënë Hyji. ²Prandaj ai që i kundërshton pushtetin i kundërshton rendit të vendosur prej Hyjit; ata që e kundërshtojnë, dënojnë vetveten. ³Sepse eprorët nuk kanë pse të druhen kur veprohet mirë, por kur veprohet keq. A dëshiron të mos ta druash pushtetin? Bëj të mirën dhe do të fitosh lëvdata prej pushtetit! ⁴Sepse pushteti është shërbëtor i Hyjit – për të mirën tënde. Përkundrazi, nëse bën keq, trembu! Nuk e mbart kot shpatën! Shërbëtori i Hyjit është: shfren hidhërimin e Hyjit në atë që bën të keqen. ⁵Prandaj duhet të nënshtrohemi, jo vetëm për shkak të frikës së ndëshkimit, por edhe për arsye të ndërgjegjes. ⁶po për këtë arsye duhet të paguani edhe tatimet: sepse ata që merren me këtë gjë janë nëpunësit e Hyjit. ⁷Jepni gjithkujt çka i përket: tatimtarit tatimin, doganierit doganën, atij që është për t’u drujtur drojën, atij që është për nderim, nderin.” Bibla. Shkrimi i Shenjtë: Besëlidhja e Vjetër dhe Besëlidhja e re, Përktheu dhe shtjelloi Dom Simon Filipaj. Ferizaj: Drita 1994, f. 1603.

⁶⁷ “Mt 22,21: *Jepni pra Cezarit çka i përket Cezarit e Hyjit çka i përket Hyjit.*” Po aty, f. 1415.

⁶⁸ Jörg Dittmer “Einleitung zur Gattung und zum historischem Umfeld der Märtyrerakten”. URL:

komunitetet e krishtera gjatë ritualeve të tyre flijoheshin njerëz, të cilëve pastaj ua hanin mishin.⁶⁹ Kjo ishte një keqinterpretim i eukaristisë, sipas së cilës buka dhe vera simbolikisht kthehen në mishin dhe gjakun e Krishtit dhe pastaj hahen e pihen nga pjesëmarrësit e ceremonisë.⁷⁰

Kësaj i shtohet edhe sjellja e të krishterëve ndaj botës pagane. Të krishterët i shmangeshin bashkëjetesës publike me të tjerët: ata shmangnin postet zyrtare dhe ato profesione, që kishin të bënin direkt me botën pagane, nuk frekuentonin cirqet, nuk vizitonin amfiteatrot dhe teatrot, nuk merrnin pjesë në gostitë e idhujve të ndryshëm.⁷¹ Pra ky vetizolim, kjo sjellje e tyre distancuese ndaj botës së jashtme, i bënte ata të dyshimtë dhe mori gradualisht përmasat e një urrejtjeje dhe ata konsideroheshin për këtë edhe si keqbërës dhe madje edhe si komplotistë. Kur binin fatkeqësitë, sëmundjet, djegiet, sulmet shfarosëse të barbarëve, kur kishte mungesë buke, etj. etj., bëheshin kryesisht të krishterët fajtorë se nuk kishin qenë mirënjohës ndaj perëndive pagane, i kishin zemëruar ato, dhe prandaj kishte ardhur ndëshkimi.⁷²

Edikti i Milanos (viti 313) dhe liria fetare

Me Ediktin e Milanos, të shpallur nga Konstantini, i quajtur më vonë i Madh (i lindur në Nish të Dardanisë më 270) dhe Licini, pretendenti tjetër i fronit, situata e të krishterëve ndryshoi për mirë në të gjithë Perandorinë Romake dhe si pjesë të saj, edhe në Iliri. Këtij edikti, i cili prej studiuesve jepet edhe me emrin “Marrëveshja e Milanos”⁷³ i paraprin një edikt tjetër i vitit 311 i perandorit Galerius, i cili po ashtu është një edikt tolerance që i jep fund persekutimit të krishterëve dhe e bën

<http://www.chairete.de/Beitrag/Passio%20Perpetuae/Einleitung%20Maertyrerakten.pdf> (10. 9. 2013)

⁶⁹ Karl Grimberg, *Historia botërore dhe qytetërimi 3*, përktheu nga origjinali Pëllumb Nako (Titulli në origjinal: *Världshistoria, Folkens Liv och Kultur.*), Tiranë: Uegen 2003, f. 194. (Cituar si: K. Grimberg, *Historia botërore dhe qytetërimi 3*, f.)

⁷⁰ *Po aty.*

⁷¹ Jörg Dittmer, “Einleitung zur Gattung und zum historischem Umfeld der Märtyrerakten”. URL:

<http://www.chairete.de/Beitrag/Passio%20Perpetuae/Einleitung%20Maertyrerakten.pdf> (10. 9. 2013).

⁷² *Po aty.*

⁷³ *Wörterbuch des Christentums. 1500 Stichwörter von A bis Z.* Hrsg. v. Volker Drehsen [u. a.] Genehm. Sonderausg. München: Orbis 2001, f. 670. (Në vijim cituar si: *Wörterbuch des Christentums*, f.)

Krishterimin “*religio licita*” religjion të ligjshëm,⁷⁴ duke i dhënë atij të drejta të barabarta me kultet e vjetra romake.⁷⁵

Edhe perandori Galerius Maksimius (Galerius Maximinus) para se të bënte ediktin e lartpërmendur që një ndër perandorët përndjekës më të ashpër ndaj të krishterëve.⁷⁶ Gjatë këtyre përndjekjeve u martirizua edhe i krishteri Urficius, martirizimi i të cilit përkujtohet më 14 gusht.⁷⁷ Ai para se të ekzekutohej me shpatë, u torturua shumë dhe në mënyra të ndryshme, për emrin e Krishtit,⁷⁸ por nuk dihet vendi se ku ndodhi kjo ngjarje. Po ashtu në kohën e Galeriusit⁷⁹ u martirizua në Siscia të Ilirisë në vitin 304 (sot Sisak në Kroaci) Shën Kuirini (Quirinus) që ishte

⁷⁴ “XXXIII. 11. ... Et iam deficiens edictum misit huiusmodi. XXXIV. ‘ Inter cetera quae pro rei publicae semper commodis atque utilitate disponimus, nos quidem volueramus antehac iuxta leges veteres et publicam disciplinam Romanorum cuncta corrigere atque id providere, ut etiam Christiani, qui parentum suorum reliquerant sectam, ad bonas mentes redirent, 2. siquidem quadam ratione tanta eosdem Christianos voluntas invasisset et tanta stultitia occupasset, ut non illa veterum instituta sequerentur, quae forsitan primum parentas eorundem constituerant, sed pro arbitrio suo atque ut isdem erat libitum, ita sibimet leges facerent quas observarent, et per diversa varios populos congregarent. 3. Denique cum eiusmodi nostra iussio extitisset, ut ad veterum se instituta conferrent, multi periculo subiugati, multi etiam deturbati sunt. 4. Atque cum plurimi in proposito perseverarent ac videremus nec diis eosdem cultum ac religionem debitam exhibere nec Christianorum deum observare, contemplatione mitissimae nostrae clementiae intuentes et consuetudinem sempiternam, qua solemus cunctis hominibus veniam indulgere, promptissimam in his quoque indulgentiam nostram credidimus porrigendam. Ut denuo sint Chrsitiani et conventicula sua componant, ita ut ne quid contra disciplinam agant. 5. <Per> aliam autem epistolam iudicibus significaturi sumus quid debeant observare. Unde iuxta hanc indulgentiam nostram debebunt deum suum orare pro salute nostra et rei publicae ac sua, ut undique versum res publica praestetur incolumis et securi vivere in sedibus suis possint. ’ XXXV. Hoc edictum proponitur Nicomediae pridie Kalendas Maias ipso octies et Maximino iterum consulibus.” Edictum Tolerationis. URL: http://webu2.upmf-grenoble.fr/DroitRomain/Constitutiones/ed_tolerat.htm (26. 4. 2013)

⁷⁵ K. Grimberg, *Historia botërore dhe qytetërimi* 3, f. 263.

⁷⁶ M. Grant, *Konstandini i Madh*, f. 151.

⁷⁷ “Urficius mart. in Illyrico sub Maximiano. 14 August”. *Martyrologium Romanum*. Index, f. 37.

⁷⁸ “In Illyrico sancti Ursicii Martyris, qui, sub Maximiano Imperatore et Aristide Praeside, post multa et diversa tormenta, pro Christi nomine, gladio caesus est.” *Martyrologium Romanum*, f. 155.

⁷⁹ Në tekstin më poshtë jepet *sub Galerio Praeside* “pra nën Galeriusin Epor”, mendoj pra se këtu bëhet fjalë për perandorin Galerius, pasi ngjarja duket se ka ndodhur në vitin 304.

ipeshkëv i atij vendi. Sipas legjendës shën Kuirinit i lidhën në qafë një gurë dhe e hodhën në lumë, guri nuk u zhyt por notoï duke i dhënë mundësi Kuirinit që t'u përgjerohej të krishterëve të tjerë që ndodheshin aty përreth, që të mos të frikësoheshin nga ekzekutimi i tij dhe të mos lëkundeshin nga besimi. Pasi i tha këto fjalë ai u bë martir me vullnetin e Zotit, dhe guri që kishte të lidhur në qafë e tërhoqi atë brenda në ujë duke e mbytur, siç shkruan Prudentiusi.⁸⁰

Edikti i Milanos u bë më 13 qershor të vitit 313 dhe u konfirmoi të krishterëve edhe një herë lirinë e besimit, që e kishin përfituar që me ediktin e vitit 311. Ai u bënte të mundur atyre kthimin e pronës kishtarë dhe të asaj private në ato raste që ishin marrë, kthimin e vendeve ku mbledheshin, kishave të tyre u jepej status ligjor (*Corpus christianorum*). Të krishterëve u garantohej liri e papenguar dhe e pakufizuar në ushtrimin e besimit të tyre, dhe secili që kishte dëshirë mund të bëhej i krishterë, ose të zgjidhte religjionin që kishte dëshirë.⁸¹ “Denigrimi nga çdo e drejtë, pësuar nga të krishterët për gjatë disa shekujve, tashmë u fshi përfundimisht.”⁸²

Shkaqet e përpilimit të një edikti të tillë mundohet ti shpjegojë **Eusebius i Cesareas** (i quajtur ndryshe **Eusebius Pamphili**), i cili ishte një historian roman dhe ekzeget (interpretues) i krishterë. Sipas legjendës që jep Eusebius, Konstandinit, kur po bënte betejën kundër Maksentiusit, tek Ura Milvio i shfaqet një natë para betejës, në ëndërr, shenja e monogramit të Krishtit HR (XP) me fjalët “*In hoc signo vinces*” (nën këtë shenjë do të fitosh) ose “*In hoc signo vince*” (nën këtë shenjë fito).⁸³

Konstandini i vendos këto shenja nëpër flamujt e ushtarëve të tij dhe kështu del fitimtar. Kurse një variant tjetër i kësaj ngjarjeje thotë që “*perandori i ardhshëm ka kërkuar ndihmën e këtij zoti (Zotit të të krishterëve- E.M.); fakt sipas të cilit ai do të ketë pasur një vegim, duke*

⁸⁰ “*Sisciae, in Illyrico, sancti Quirini Episcopi, qui, sub Galerio Praeside, pro fide Christi (ut Prudentius scribit), molari saxo ad collum ligato, in flumen praecipitatus est; sed, lapide supernatante, cum circumstantes Christianos, ne ejus terrentur supplicio neve titubarent in fide, diu fuisset hortatus, ipse, ut martyrii gloriam assequeretur, precibus a Deo, ut mergeretur, obtinuit.*” Martyrologium Romanum, f. 104.

⁸¹ *Das Edikt von Mailand, Januar 313*. URL: <http://www.unifr.ch/bkv/kapitel500-47.htm> (20. 2. 2013).

⁸² K. Grimberg, *Historia botërore dhe qytetërimi* 3, f. 263.

⁸³ Eusebius, *The Church History*, Translation and commentary by Paul L. Maier. Kregel Academic & Professional 2007, f. 305.

parë të vizatuar në qiell një shpatë me këto shkronja: “In hoc signo vinces”.⁸⁴ Pra, sipas këtyre varianteve legjendare, për fitoren në luftë qe vendimtare shenja e religjionit të krishterë, të cilin perandori Galerius e kishte bërë zyrtar një vit më parë. Shkaqet e shndërrimit total të qëndrimit ndaj religjionit të krishterë jepen nga Eusebius si shkaqe që ndodhin për arsye besimi, por në të vërtetë liria që iu dha të krishterëve ishte një gjest politik, e jo një gjest i shtyrë nga bindja fetare.⁸⁵

Ne dimë tashmë që Konstandini i Madh edhe më vonë mbeti adhures i *kultit të Diellit*,⁸⁶ dhe u pagëzua si i krishterë vetëm në fund të jetës së tij, kur po dergjej në shtratin e vdekjes. Atëherë lind pyetja “*pse kjo simpati për të krishterët?*”. Konstandini kishte mbetur tepër i tronditur nga përndjekjet e të krishterëve, e cila u bëhej atyre për t’i diskriminuar dhe për t’u nxjerrë bojën, dhe sepse ata nuk merrnin pjesë në aktet e adhurimit dhe nuk përmbushnin si duhet detyrimet e ndryshme ushtarake.⁸⁷ Arsyet e vërteta për këtë simpati të perandorit ndaj besimit të krishterë kanë qenë të shumta. Siç e kam shprehur edhe në një kumtesë më parë⁸⁸, unë jam i mendimit që Konstandini kishte vënë re disa karakteristika të krishterëve që besimet e tjera nuk i kishin.

Të krishterët me gjithë persekutimin gjatë shekujve, ishin shtuar në numër dhe përbënin një pjesë të mirë të popullsisë. Sipas Karl Grimberg, numri i të krishterëve po rritej, sidomos në Lindje, duke përbërë në këtë mënyrë 10% e ndoshta më shumë të popullsisë së perandorisë.⁸⁹

Ata ishin të organizuar në mënyrë të përsosur, dhe pavarësisht nga grindjet midis tyre për shkak të herezive, kishin arritur të krijonin grupe kulti shumë të organizuara, duke ngritur bile shoqata zejtarësh dhe shoqëri, aktiviteti i të cilave për besimtarët qe i ndryshëm, duke përfshirë këtu edhe ceremoni varrimi, shoqata ndihmëse për të varfrit dhe bile edhe pensione.⁹⁰

⁸⁴ K. Grimberg, *Historia botërore dhe qytetërimi 3*, f. 263.

⁸⁵ Z. Mirdita, “Gjashtë shekujt e parë të Krishtenizmit ...”, f. 44.

⁸⁶ Po aty.

⁸⁷ M. Grant, *Konstandini i Madh*, f. 152.

⁸⁸ Edmond Malaj, “Toleranca fetare në Ediktin e Milanos (313) dhe tradita e mëvonshme”, kumtesë e mbajtur në simpoziumin ndërkombëtar me titull: *Konstantini: 1700 Vjetori i Ediktit të Milanos dhe Liria Fetare*, organizuar nga Konferenca Ipeshkvnore e Shqipërisë dhe Caritas Shqiptar, Tiranë, më 27. 4. 2013.

⁸⁹ K. Grimberg, *Historia botërore dhe qytetërimi 3*, f. 263.

⁹⁰ M. Grant, *Konstandini i Madh*, f. 153.

Të krishterët kishin një ndjenjë të madhe bashkësie dhe bashkësitë e tyre kishin lidhje shumë të ngushta saqë frikësonin edhe vetë perandorët, kështu që, “Diokleciani, Galeri por edhe të tjerë, u shqetësuan së tepërmi për lidhjet që ekzistonin në bashkësitë e krishtera. Ata i shihnin këto bashkësi si kundërshtarë dhe si kërcënim për vetë unitetin e perandorisë.”⁹¹ Përkundrazi, Konstantini vuri re se, “komunitetet e krishtera ishin shembulli i shtetit romak, të anëtarësuar në një grupim, ata udhëhiqeshin nga një klerik i zgjedhur prej popullit.”⁹² Kisha ishte bërë një shtet brenda shtetit.⁹³ Ata kishin besim të fortë e të zjarrtë brenda tyre, dhe nuk kishin frikë nga vdekja, ndërsa pjesa më e madhe e paganëve ishin të përkorë ose indiferentë në problemet fetare.⁹⁴ Anëtarët e këtij grupimi fetar ishin të ndershëm dhe rezistentë, dhe nuk shikonin kurrë që të përvetësonin pronën e tjetrit.

Këto cilësi e kishin bërë krishterimin që të mbijetonte gjatë gjithë antikitetit, dhe prandaj nuk duhet të lihej jashtë vëmendjes. Dhe Konstantini si njeri i zgjuar dhe i vëmendshëm nuk i kishin ikur pa i vënë re këto cilësi të një grupi të shtetasve të tij, cilësi këto që e bënë atë ta respektonte në mënyrë të veçantë këtë komunitet fetar, dhe në fund të jetës së tij të pranonte edhe besimin e tyre. Pra kjo pikëpamje mund të jetë edhe një këndvështrim i ri për të shpjeguar simpatinë e perandorit Konstantin për religjionin e krishterë, krejt ndryshe nga perandorët e tjerë paganë romanë që e kishin parë krishterimin e mirëorganizuar si një kërcënim për ta.⁹⁵ Simpatia e tij mund të ketë pasur kryesisht arsye politike. “*Sensi politik tepër i mbrehtë si dhe një farë largpamësie lidhur me çështjet fetare e bënë Konstantinin tolerant*”⁹⁶.

Konstantini e kishte kuptuar se, sa të rëndësishëm mund t’i bëheshin të krishterët po t’i kishte përkrah tij.⁹⁷ Por, sipas burimesh të tjera, ky afrim i Konstantinit ndaj Krishterimit nuk mund të shihet si oportunitizëm politik, por si qëndrim besimi ndaj këtij religjioni.⁹⁸ Kjo periudhë hyn në histori me emrin “*Kthesa Konstantiniane*”, dhe ka të bëjë pra me afrimin

⁹¹ *Po aty*.

⁹² K. Grimberg, *Historia botërore dhe qytetërimi* 3, f. 264.

⁹³ *Po aty*.

⁹⁴ *Po aty*.

⁹⁵ M. Grant, *Konstantini i Madh*, f. 153.

⁹⁶ K. Grimberg, *Historia botërore dhe qytetërimi* 3, f. 264.

⁹⁷ *Po aty*, f. 263.

⁹⁸ *Wörterbuch des Christentums*, f. 670.

e Konstantinit karshi Krishterimit, i cili për të qe një proces që zgjati tërë jetën deri me pagëzimin e tij, që e kreu, para vdekjes kur po dergjej në shtrat, siç e thashë edhe më sipër.

Megjithatë, ai fëmijëve të tij u dha edukim të krishterë, dhe më 325 organizoi dhe mori pjesë në Koncilin e Nikeas, për të cilin do të flasim pak më poshtë. Ndoshta pagëzimi i tij pak para vdekjes ka të bëjë me një zakon të shpeshtë të asaj kohe, bazuar në dëshirën e çdo njeriu për të hyrë në pavdekësi i pastruar nga çdo mëkat.⁹⁹

Gjatë kthesës konstantiniane pati shumë ndryshime ligjesh në perandori, të bazuara në konceptet sociale të krishtera, si për shembull, dita e diel si ditë pushimi, ku gjykatat nuk lejoheshin të mblidheshin dhe ushtarët kishin pushim; ndalimi i damkosjes së fytyrës së njerëzve me hekur të skuqur; ndalimi i kryqëzimit; lehtësime ligjore për skllëvërit, etj. etj.¹⁰⁰ Kishat armene, greke dhe ruse (pra kishat e ritit lindor) e kanë shenjtëruar figurën e Konstantinit, dhe më 21 maj është festa e tij.¹⁰¹

Krishterimi në trojet iliro-shqiptare pas Ediktit të Milanos

Pas Ediktit të Milanos gjendja e krishterimit, statuti i tij ligjor ndryshoi dhe krishterimi tashmë ishte një religjion i lirë, dhe kjo ndodhi në të gjithë perandorinë duke përfshirë edhe trojet ilire, por në Dardani gjendja për të krishterët nuk u përmirësua menjëherë pasi aty ishte Licini (kunat i Konstantinit), i njohur si persekutor i të krishterëve. Konstantini e mundi atë në betejën e Cibalës.¹⁰² Licini, edhe pse kishte qenë pjesëmarrës në përpilimin dhe shpalljen e Ediktit të Milanos, duket se pati rënë edhe një herë në urrejtje ndaj të krishterëve, dhe nga ana tjetër marrëdhëniet e tij me Konstantinin, kunatin e tij, me të cilin për njëfarë kohe kishte bashkëqeverisur, nuk kishin qenë kurrë të mira.¹⁰³ Pas kësaj ngjarjeje ndryshoi situata e tyre në Dardani.

Krishterimi në Iliri mori zhvillim të madh dhe të krishterët ilirë i kemi të pranishëm edhe në koncilet kryesore siç ishte ai i Nikeas në vitin

⁹⁹ K. Grimberg, *Historia botërore dhe qytetërimi 3*, f. 270.

¹⁰⁰ *Po aty*, f. 269.

¹⁰¹ *Po aty*, f. 270. Shih edhe: Feast of the Holy Great Sovereigns Constantine and Helen, Equal to the Apostles. May 21. URL:

<http://www.goarch.org/special/constantineandhelen> (20. 8. 2013)

¹⁰² G. Gjini, *Ipeshkvia Shkup-Prizren nëpër shekuj*, f. 27.

¹⁰³ K. Grimberg, *Historia botërore dhe qytetërimi 3*, f. 270.

325, që u mbajt në prani të afërsisht 300 peshkopëve në pallatin e vetë Konstantinit në Nikea të Bitynisë,¹⁰⁴ ku mori pjesë ipeshkvi Dakus i Dardanisë nga Shkupi (*Dacus Dardaniae, Scupi*)¹⁰⁵ dhe mesa duket edhe ipeshkvi Budi i Stobit (*Budius Stobiensis*).¹⁰⁶ Koncili ekumenik i Nikeas u mbledh, ndër të tjera, edhe për të dënuar mësimet e Ariusit të Aleksandrisë. Arius në koncilin e Nikeas më 325 kishte refuzuar të fliste për Jezus Krishtin, sikur të fliste për Zotin (pra njëjësinë apo *konsubstancialitetin*). Ai në koncilin e Nikeas humbi në diskutimin teologjik që bëri kundër dy priftërinjve aleksandrinë Atanazi dhe Aleksandri, u dëbua së bashku me disa peshkopë të tjerë, që përkrahnin doktrinën e tij,¹⁰⁷ dhe mesa duket u syrgjynos në Iliri¹⁰⁸. Pra, trojet ilire u prekën nga mësimet e Ariusit.

Arianizmi, pas vdekjes së perandorit Konstanc më 361 erdhi e u tkurr edhe më tepër dhe humbi terren edhe në trojet ilire dhe kështu ipeshkëvinjtë ilirë përvetësojnë gjithnjë e më tepër doktrinën e konssubstancialitetit të Atit e të Birit.¹⁰⁹ Tani përta i përket pjesëmarrjes së ipeshkëvijve të Ilirisë ndër sinode të tjera mund të shtojmë këtu që në Sinodin e Sardikës (343) gjejmë edhe emrat e *Paregorius a Dardania de Scupis*,¹¹⁰ *Gaudentius nga Naissusi*, që konsiderohej si njeri me autoritet ndër etërit e koncilit¹¹¹ dhe *Macedonius nga Ulpiana*.¹¹² Ndërsa në

¹⁰⁴ Emil Nack/ Wilhelm Wägner, *Rom. Land und Volk der alten Römer*. Neu bearb. Ausg. Wien: Ueberreuter 1976, f. 305. (Në vijim cituar si: E. Nack/ W. Wägner: *Rom*, f.)

¹⁰⁵ Z. Mirdita, "Gjashtë shekujt e parë të Krishtenizmit ...", f. 45.

¹⁰⁶ Jahja Drançolli, "Konstandini i Madh në kontekstin dardan dhe Dardani", në: *Buzuku-b* (Revistë e pavarur informative, kulturore e shoqërore), Ulqin: e hënë 15 korrik 2013, nr. 39, f. 11.

¹⁰⁷ E. Nack/W. Wägner, *Rom*, f. 305.

¹⁰⁸ *Das Christentum zur Zeit Kaiser Konstantins I. des Großen (306 - 337)* URL: <http://geschichtsverein-koengen.de/Christentum2.htm> (15. 9. 2013)

¹⁰⁹ Z. Mirdita, "Gjashtë shekujt e parë të Krishtenizmit" f. 46.

¹¹⁰ "An. 347 subscriptus Canonibus Synodi Sardicensis, Paregorius a Dardania de Scupis, tum eiusdem synodicae epistulae ad Julium P. Paregorius a Dardania de Scupis, & alteri encyclicae ad omnes, Paregoirus" J. Coleti, *Illyricum Sacrum VIII*, f. 4.

¹¹¹ "Adfuit, Concilio Sardicensi an. 347, multumque valuit auctoritate apud Patres Concilii". *Po aty*, f. 33.

¹¹² "In Concilio Sardicensi stetit pro S. Athanasios adversus Arianos, & decretis subscripsit; Macedonius a Dardania de Ulpianis, tum Synodicae epistulae ab Julium Pontificem, Macedonius ab Adania lege Dardania de Ulpianis, atque alteri ad omnes Eposcopos, Macedonius". *Po aty*, f. 41.

Koncilin e Kostandinopojës (381) dhe në Koncilin e Efesit (431) kemi të pranishëm Senecion arqipeshkvin e Shkodrës¹¹³ dhe arqipeshkvin e Durrësit, i cili i shoqëruar nga sufraganët e tij nënshkroi aktin përzundimtar që dënonte nestorianizmin si herezi.¹¹⁴ Kurse në Koncilin e Kalcedonisë në vitin 451 morën pjesë Luka, mitropoliti i Durrësit, Evandri ipeshkëv i Dioklesë dhe Euzebi, ipeshkëv i Apolonisë.¹¹⁵

Krishterimi gjatë kësaj kohe, pas Ediktit të Milanos ishte fuqizuar së tepërmi dhe në fund të shekullit V, nëse do të kufizoheshim në trojet që sot janë shqiptare kishim këto ipeshkvi: Durrësi, Doklea Shkodra, Sarda, Lisus stampa, Amantia, Apolonia, Byllis, Aulona, ndoshta edhe Ulqini¹¹⁶ në anën perëndimore kurse në anën lindore Shkupin si arqipeshkvi, Ulpianën, Neutianën, Diokletianën, Merianën që i përkisnin trevës së Dardanisë.¹¹⁷

* * *

Këto ishin pra disa të dhëna mbi krishterimin në Iliri gjatë antikitetit, duke u kufizuar kryesisht në përhapjen e këtij religjioni nga vetë figurat kryesore të tij, si Pali, Titi, Cezari, etj., dhe në martirizimin deri para Ediktit të Milanos. Kurse dy pjesët e fundit të artikullit synuan të hedhin dritë mbi tolerancën fetare që të krishterët përfituan nga Edikti i Milanos (viti 313), si dhe disa ndryshime pozitive që pati krishterimi pas këtij edikti, duke pasur parasysh këtu në lidhje me të edhe zhvillimi në Iliri.

¹¹³ M. Peters, "Die ekklesiale Geographie Albaniens bis zum Ende des 6. Jahrhunderts", në: *Krishtërimi ndër shqiptarë*, f. 105.

¹¹⁴ *Historia e Popullit Shqiptar I*, f. 202.

¹¹⁵ *Po aty*.

¹¹⁶ Milan von Šufflay, "Kirchenzustände im vortürkischen Albanien. Die orthodoxe Durchbruchzone im katholischen Damme", në: *Illyrisch-Albanische Forschungen*. Unter Mitwirkung von Professor Dr. Konstantin Jireček, Professor Dr. Milan von Šufflay, Sektionsschef Theodor Ippen, Professor E. C. Sedlmayr, Archivar Dr. Josef Ivanič, Weiland Emmerich von Karácson, K. Ung. Sektionsrat Béla Péch und Karl Thopia. Zusammengestellt von Dr. Ludwig von Thallóczy. I. Band. Mit einer Landkarte. München/Leipzig: Duncker und Humblot 1916, f. 193.

¹¹⁷ Z. Mirdita, "Gjashtë shekujt e parë të Krishtenizmit ...", f. 52.

*S u m m a r y*DATA ON CHRISTIANITY IN ILLYRIAN-ALBANIAN TERRITORIES BEFORE AND
AFTER THE EDICT OF MILAN (YEAR 313)

In this article, I am trying to give a general overview about the Christianity in the Illyrian territories from the beginning until the time, after the Edict of Milano (313). With Illyrian territories, I mean here the lands where Albanian people live today. In the Center of this article is the martyrdom of the first Christians. I shall bring many details from their lives and their contribution to spread the Christian religion and the legend about their sacrifice. After the Edict of Milano, the situation of Christians changed totally; Konstantin the Great gave the Christians the religious freedom, so it began e new period, which opened to the Christianity to become e religion of state in the Roman and later in the Byzantine Empire.

